VENDIM
Nr.155, datë 19.12.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR PËRJASHTIMIN NGA AKSESI I PALËVE TË TRETA TË PARAQITUR NGA ANA E KOMPANISË TAP

Në mbështetje nenit 40 të ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror" dhe nenit 18, germa "e", të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE–s", miratuar me vendimin nr.107, datë 17.10.2011 të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin nga aksesi i palëve të treta, të paraqitur nga ana e kompanisë TAP.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë kompaninë TAP për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani